



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 19 Prot.

Korce me: 08.01.2019

VENDIM

Nr. 6, datë 08.01.2019

PËR MIRATIMIN E NDARJES SE GRANTIT BUXHETOR

Bordi i Administrimit i Universitetit "Fan S. Noli", i mbledhur ne daten 08 / 01 / 2019, pasi shqyrtoi kerkesen e Administratorit te Universitetit per: miratimin e ndarjes se grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit per vitin 2019; në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika "a", "ë";:

VENDOSI

1. Miratimin e ndarjes se grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit per vitin 2019, Granti i mesimdhenies (paga dhe sigurime), dhe Granti i mbeshtetjes studentore (bursa).
(bashkëngjitur materiali perkates).
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

Bordi i Administrimit

KRYETARI

Sofjola Kotelli

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 186 Prot.

Korçë, më 29.01.2019

VENDIM

NR. 43, DATË 29.01.2019

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 439, DATË 02.07.2018,
"PËR MIRATIMIN E TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT
PËR ÇDO PROGRAM STUDIMI PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019",
TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 29/01 / 2019, pasi u njoh me VKM nr. 778, datë 26.12.2018, "Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar, bazuar në këtë vendim të Këshillit të Ministrave,

Vendosi:

1. Të miratojë ndryshimet përkatëse në tarifën vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, në rastin kur ndiqen si program i parë studimi, të përcaktuara në vendimin nr.439, datë 02.07.2018, "Për miratimin e tarifave vjetore të shkollimit për çdo program studimi për vitin akademik 2018-2019", të Bordit të Administrimit.
2. Tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë (program i parë studimi), të ndryshuara janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij.
3. Bazuar në pikën 1/1, të VKM-së nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit, për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", të ndryshuar,

studentët, të cilët rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit të parë akademik, nga viti akademik 2019-2020 e në vijim paguajnë tarifën e plotë të studimit, për programin përkatës të studimit të ciklit të parë, Bachelor/programit përkatës të studimeve profesionale me kohë të plotë, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur vendimit nr.439, datë 02.07.2018, “Për miratimin e tarifave vjetore të shkollimit për çdo program studimi për vitin akademik 2018-2019”, të Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli



**TARIFAT E PROGRAMEVE TE STUDIMIT TE UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI" PER
VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Tarifat vjetore të shkollimit për çdo program studimi të ciklit të parë (BACHELOR)	
Program i studimit	Tarifa vjetore për program të parë
Gjuhë-Letërsi	10,000
Gjuhë dhe kulturë frënge	10,000
Gjuhë Angleze	10,000
Mësuesi për Arsimin Fillor	10,000
Mësuesi për Arsimin Parashkollor	10,000
Histori-Gjeografi	10,000
Filozofi-Sociologji	10,000
Matematikë-Fizikë	10,000
Matematikë-Informatikë	10,000
Biologji-Kimi	10,000
Teknologji-Informacioni	10,000
Infermeri e Përgjithshme	10,000
Mami (Infermier)	10,000
Administrim dhe Politika Sociale	10,000
Financë - Kontabilitet	10,000
Menaxhim	10,000
Administrim Biznesi në Marketing	10,000
Administrim Biznesi në Turizëm	10,000
Agroushqim	10,000
Menaxhim Agrobiznesi	10,000
Inxhinieri Agronomike	10,000
Mjekësi e Bimëve dhe Hortikulturë	10,000
Biznes dhe Tregti	10,000
Informatikë Biznesi	10,000
Ekonomiks	10,000
Tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të karakterit profesional 2-vjeçar pas arsimit të mesëm	
Edukim për foshnjërinë dhe fëmijërinë e hershme	10,000
Menaxhim Biznesi Bujqësor	10,000
Teknika e prodhimit të farave dhe fidanëve	10,000
Menaxhim veterinar	10,000
Shërbim Social	10,000
Mbështetës zyre për komunikim, bibliotekë dhe arkiv	10,000
Asistent Menaxher	10,000

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 187 Prot.

Korçë, më 29.01.2019

VENDIM

NR. 44, DATË 29.01.2019

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 774, DATË 26.12.2018,
"PËR MOSPËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, TË DISA STUDENTËVE
TË VITIT I, II & III, TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR",
TË NDRYSHUAR, TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas përfundimit të afatit shtesë për paraqitjen e dokumenteve vërtetuese nga ana e studentëve për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 29/01/2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga disa studentë, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, forma e studimeve me kohë të plotë, që pretendojnë të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe pas verifikimeve të kryera në lidhje me vërtetimet e paraqitura nga studentët për trajtimin e familjeve të tyre me ndihmë ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga të cilat rezultoi se disa prej tyre nuk trajtoheshin, bazuar në VKM nr.269, dt.29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar,

Vendosi:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.774, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, "Për mospërjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-2019, të disa studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor", të ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 14.01.2019, të Bordit të Administrimit dhe njëkohësisht listën përfundimtare të përditësuar të studentëve, për të cilët, bazuar në dokumentet e paraqitura dhe verifikimet e kryera, nuk vërtetohet se i përkasin ndonjëres prej kategorive të individëve të përcaktuara në pikën 1, të VKM nr.269, dt.29.03.2017, të ndryshuar, të cituar më lart, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë të tij, që zëvendëson listën bashkëlidhur

vendimit nr.774, datë 26.12.2018, të ndryshuar, të Bordit të Administrimit,
“Për mospërfundimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-
2019, të disa studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve,
Bachelor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 188 Prot.

Korçë, më 29.01.2019

VENDIM

NR. 45, DATË 29.01.2019

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LISTËN E STUDENTËVE
QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT
ME VENDIMIN NR. 773, DATË 26/12/2018, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN
NR. 15, DATË 14.01.2019, TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT
DHE MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE
TË PËRDITËSUAR ME KËTO SHTESA DHE NDRYSHIME**

Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas përfundimit të afatit shtesë për paraqitjen e dokumenteve vërtetuese nga ana e studentëve për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 29/01/2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, forma e studimeve me kohë të plotë, që pretendojnë të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, si dhe pas verifikimeve të kryera në lidhje me vërtetimet e paraqitura nga studentët për trajtimin e familjeve të tyre me ndihmë ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga të cilat rezultoi se disa prej tyre nuk trajtoheshin, bazuar në VKM nr.269, dt.29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar,

Vendosi:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.773, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, "Për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I II & III, të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor", të ndryshuar dhe njëkohësisht listën përfundimtare të studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të VKM nr.269, dt.29.03.2017, të cituar më lart, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, të përditësuar me këto shtesa dhe ndryshime, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e

tij, që zëvendëson listën bashkëlidhur vendimit nr.773, datë 26.12.2018, të ndryshuar, të Bordit të Administrimit.

2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 241 Prot.

Korçë, më 04.02.2019

VENDIM

NR. 64, DATË 04.02.2019

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 775, DATË 26.12.2018,
"PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, TË
STUDENTËVE TË VITIT II & III, TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE,
BACHELOR", TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Pas ndryshimeve të bëra me VKM nr. 39, datë 23.01.2019 në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 04/02/2019, pasi u njoh me listën shtesë të studentëve që përfitojnë sipas pikës 1, të vendimit të Këshillit të Ministrave, të cituar më sipër, të hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 704, datë 13.11.2018, të administratorit të institucionit dhe me një ndryshim në listën e studentëve të programeve të studimit në fushën e mësuesisë, me mesatare nga 9-10, të miratuar me vendimin nr. 775, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, si dhe me listën e studentëve të vitit II & III, që kanë aplikuar dhe përfitojnë bursë për herë të parë, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», neni 47, si dhe në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kritereve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», i ndryshuar,

Vendosi:

1. Të miratojë shtesat në vendimin nr. 775, datë 26.12.2018, "Për miratimin e bursave për vitin akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor", të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, pika 1, të cituar më lart

sipas listës, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.

2. Të miratojë një ndryshim në listën e studentëve të programeve të studimit në fushën e mësuesisë, me mesatare nga 9-10, të miratuar me vendimin nr. 775, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.
3. Të miratojë shtesat në vendimin nr. 775, datë 26.12.2018, “Për miratimin e bursave për vitin akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor”, të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të studentëve të vitit II & III, që përfitojnë bursë për herë të parë, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.
4. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 242 Prot.

Korçë, më 04.02.2019

VENDIM

NR. 65, DATË 04.02.2019

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 776, DATË 26.12.2018, "PËR MOSMIRATIMIN E BURSIVE TË DISA STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019," TË NDRYSHUAR, DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 775, DATË 26.12.2018, "PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, TË STUDENTËVE TË VITIT II & III, TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR", TË NDRYSHUAR, TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 04/02/2019, pasi u njoh me listën shtesë të studentëve që përfitojnë sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», të ndryshuar, të hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 704, datë 13.11.2018, të administratorit të institucionit, si dhe me një ndryshim në listën e studentëve të cilët nuk përfitojnë bursë për mosplotësim të kriterëve të përcaktuara, pjesë e vendimit nr. 776, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, të ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», neni 47, si dhe në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», të ndryshuar,

Vendosi:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në vendimin nr. 776, datë 26.12.2018, «Për mosmiratimin e bursave, të disa studentëve për vitin akademik 2018-2019», të ndryshuar, të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, sipas listës, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë

përbërëse e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.

2. Të miratojë shtesat në listën e studentëve që përfitojnë bursë, pjesë e vendimit nr. 775, datë 26.12.2018, “Për miratimin e bursave për vitin akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor”, të ndryshuar, të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, sipas listës, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.
3. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 242 Prot.

Korçë, më 04.02.2019

VENDIM

NR. 65, DATË 04.02.2019

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 776, DATË 26.12.2018, "PËR MOSMIRATIMIN E BURSIVE TË DISA STUDENTËVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019," TË NDRYSHUAR, DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 775, DATË 26.12.2018, "PËR MIRATIMIN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, TË STUDENTËVE TË VITIT II & III, TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR", TË NDRYSHUAR, TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 04/02/2019, pasi u njoh me listën shitesë të studentëve që përfitojnë sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», të ndryshuar, të hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 704, datë 13.11.2018, të administratorit të institucionit, si dhe me një ndryshim në listën e studentëve të cilët nuk përfitojnë bursë për mosplotësim të kriterëve të përcaktuara, pjesë e vendimit nr. 776, datë 26.12.2018, të Bordit të Administrimit, të ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», neni 47, si dhe në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», të ndryshuar,

Vendosi:

1. Të miratojë shitesat dhe ndryshimet në vendimin nr. 776, datë 26.12.2018, "Për mosmiratimin e bursave, të disa studentëve për vitin akademik 2018-2019", të ndryshuar, të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, sipas listës, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë

përbërëse e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.

2. Të miratojë shtesat në listën e studentëve që përfitojnë bursë, pjesë e vendimit nr. 775, datë 26.12.2018, "Për miratimin e bursave për vitin akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I, II & III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor", të ndryshuar, të Bordit të Administrimit, bazuar në përcaktimet e VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, sipas listës, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.
3. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 403 Prot.

Korçë, më 26.02.2019

VENDIM

NR. III, DATË 26.02.2019

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LISTËN E STUDENTËVE
QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT ME
VENDIMIN NR. 45, DAT 29.01.2019, QË I CILI NDRYSHOI VENDIMIN NR.
773, DATË 26.12.2018, TË NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 15, DATË
14.01.2019, TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT
DHE MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE
TË PËRDITËSUAR ME KËTO SHTESA DHE NDRYSHIME**

Sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pas përfundimit të afatit shtesë për paraqitjen e dokumenteve vërtetuese nga ana e studentëve për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit dhe për përgjysmimin e tarifës vjetore të shkollimit, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 26/02/2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, forma e studimeve me kohë të plotë dhe të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, forma e studimeve me kohë të plotë, që pretendojnë të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit ose të përfitojnë përgjysmimin e tarifës vjetore të shkollimit, si dhe pas verifikimeve të kryera në lidhje me vërtetimet e paraqitura nga studentët për trajtimin e familjeve të tyre me ndihmë ekonomike nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në **VKM nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit"**, i ndryshuar, si dhe në **VKM nr. 780, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit 50%, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë"**,

Vendosi:

1. Të miratojë disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 45, datë 29.01.2019, të Bordit të Administrimit, "Për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin

akademik 2018-2019, të studentëve të vitit I, II dhe III, të Ciklit të Parë të Studimeve, Bachelor”, të ndryshuar, si dhe studentve të Ciklit të Dytë të Studimeve (Master Profesional dhe Master Shkencor) dhe njëkohësisht të miratojë listën përfundimtare të studentëve të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të VKM nr. 269, dat 29.03.2017 dhe të kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pikës 1, të VKM nr. 780, dat 26.12.2018, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit ose përfitojnë ulje në masn 50% të tarifës së shkollimit, të përditësuar me këto shtesa dhe ndryshime, bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij, që zëvendëson listën bashkëlidhur vendimit nr. 45, datë 29.01.2019, të ndryshuar, të Bordit të Administrimit.

2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 404 Prot.

Korçë, më 26.02.2019

VENDIM

NR. 112, DATË 26.02.2019

PËR

**NJË SHITESË NË LISTËN E STUDENTËVE QË NUK PËRJASHTOHEN NGA
TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019,
ME VENDIMIN NR. 44, DATË 29.01.2019,
TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 26/02 / 2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentët, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, forma e studimeve me kohë të plotë, si dhe të paraqitur me vonesë nga studentët e ciklit të dytë të studimeve, që pretendojnë të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, bazuar në **VKM nr.269, datë 29.03.2017** "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, si dhe në **VKM nr. 780, datë 26.12.2018**, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit 50%, në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë",

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve, për të cilët, bazuar në dokumentet e paraqitura, nuk vërtetohet se i përkasin ndonjëris prej kategorive të individëve të përcaktuara në pikën 1, të VKM nr. 269, datë 29.03.2017, i ndryshuar, si dhe nuk vërtetohet se i përkasin ndonjëris prej kategorive të individëve të përcaktuara në pikën 1, të VKM nr. 780, datë 26.12.2018, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë të tij, që i shtohet listës bashkëlidhur vendimit nr. 44, datë 29.01.2019, të Bordit të Administrimit, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 774, datë 26.12.2018, "Për mospërjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2018-2019, të disa studentëve të viti të I, II, III, të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, të ndryshuar, të Bordit të Administrimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 405 Prot.

Korçë, më 26.02.2019

VENDIM

NR. 113, DATË 26.02.2019

PËR

MIRATIMIN E BURSAVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019,
TË STUDENTËVE TË VITIT I, II & III, TË REGJISTRUAR NË PROGRAMET
E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, BACHELOR DHE NË PROGRAMET E
STUDIMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË
VKM - SË NR. 39, DATË 23.01.2019, PËR DISA NDRYSHIME NË VKM - NË
NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE
PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE
PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË
PROGRAME STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE DHE STUDENTËT
NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Pas ndryshimeve të bëra me VKM nr. 39, datë 23.01.2019 në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 26/02/2019, pasi u njoh dhe shqyrtoi listën e studentëve që kanë aplikuar me dokumentacionin përkatës provues brenda afatit të përcaktuar dhe përfitojnë sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, të cituar më sipër, të hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin nr. 704, datë 13.11.2018, të administratorit të institucionit, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», neni 47, si dhe në VKM nr. 903, datë 21.12.2016, «Për përcaktimin e kriterëve dhe përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë», të ndryshuar, pikat 3.1, 4, 5 dhe 13,

Vendosi:

1. Të miratojë bursat e studentëve që kanë aplikuar me dokumentacionin përkatës provues dhe përfitojnë sipas përcaktimeve të VKM nr.903, dt.21.12.2017, të ndryshuar, të cituar më lart, pikat 3.1, 4, 5 dhe 13, *sipas listës* bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë e tij, të hartuar nga komisioni i ngritur për shqyrtimin e dokumentacionit.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Sofjola Kotelli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 635 Prot.

Korçë, më 03.04.2019

VENDIM

NR. 180, DATË 03.04.2019

PËR
ZGJEDHJEN E KRYETARIT DHE ZV/KRYETARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 03.04.2019, pas propozimit dhe votimit të kandidaturave për kryetar dhe zv/kryetar të tij, bazuar në Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Administrimit", neni 7,

Vendosi:

1. Kryetar i Bordit të Administrimit të jetë Z/Znj. Mamica Nene.
2. Zv/kryetar i Bordit të Administrimit të jetë Z/Znj. Ilir Mehmeti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT

Mamica Nene *[Signature]* *[Signature]*
Egër Ibrahim *[Signature]* *[Signature]*
Kostandin Nast *[Signature]* Ilir Mehmeti
Merruz Zera *[Signature]* *[Signature]*
Fazeli Bello *[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 636 Prot.

Korce me: 03.04.2019

VENDIM

Nr. 181, datë 03.04.2019

PËR MIRATIMIN E NDARJES SË GRANTIT BUXHETOR
(Rishpërndarje fondesh per vitin 2019 - shkresë MASR, nr. 3496, datë 27.03.2019)

Bordi i Administrimit i Universitetit "Fan S. Noli", i mbledhur në datën 03 / 04 / 2019, pasi shqyrtoi kërkesën e Administratorit të Universitetit për: miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019, (shkresë MASR, nr. 3496, datë 27.03.2019 – Per ndryshim ne planin e buxhetit te vitit 2019); në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika "a", "ë",:

VENDOSI

1. Miratimin e ndarjes së grantit buxhetor, alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019, Granti i mësimdhënies, Granti i mbështetjes studentore (bursa), dhe ndryshimin e detajimit të përdorimit të të ardhurave.

(bashkëngjitur materiali perkates).

2. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Bordi i Administrimit
KRYETARI

Momica Nece





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 637 prot

Korçë, më 03 / 04 / 2019

VENDIM

Nr. 182, datë 03.04.2019

PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETIT SIPAS
NIVELEVE

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 03.04.2019, pasi shqyrtoi propozimin e Senatit Akademik të Universitetit, përcjellë me shkresën nr.491/1 prot., datë 13.3.2019, për miratimin e numrit të punonjësve për të gjitha nivelet për vitin 2019, mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma ç,

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të punonjësve në të gjitha nivelet në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë për vitin 2019, sipas propozimit të përcjellë nga Senati Akademik i Universitetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 638 prot

Korçë, më 03/04/2019

VENDIM

Nr. 183, datë 03.04.2019

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË STUDENTËVE PËR ZHVILLIMIN E NJË
VEPRIMTARIE STUDENTORE ME KARAKTER SENSIBILIZUES,
EDUKUES DHE ARGËTUES

Mbështetur në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma a, si dhe neni 99, pika 6, si dhe bazuar në vendimin e Senati Akademik Nr. 159 prot, datë 27.03.2019, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 03.04.2019,

VENDOSI:

1. Të miratojë zhvillimin e një veprimtarie studentore me karakter sensibilizues, edukues dhe argëtues sipas kërkesës së studentëve nr.308 prot, datë 13.2.2019 dhe mbështetjen financiare prej 300.600 lek sipas tabelës bashkëngjitur
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 992 prot

Korçë, më 28/05/2019

VENDIM

Nr. 289, datë 28.05.2019

PËR

DHËNIE SHPËRBLIMI FINANCIAR STUDENTIT ADNDREA DULE

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, paragrafi 3, pika c, si dhe në propozimin e Rektoratit me nr. 619, datë 03.04.2019, "Propozim për dhënie burse studimi studentit Andrea Dule", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 27.05.2019,

VENDOSI

1. T'i akordojë shpërblim financiar z. Andrea Dule, student në Fakultetin Ekonomik, programi financë-kontabilitet, viti i dytë, djalit të mësueses Luiza Dule, e cila humbi jetën në krye të detyrës në muajin dhjetor 2018.
2. Ky shpërblim financiar të jepet për periudhen e vitit akademik 2018-2019, për muajt Maj dhe Qershor dhe për vitin akademik 2019-2020, me kushtin që studentit Andrea Dule të shlyej detyrimet e tij brenda afatit të rregullt të vitit akademik, gjatë studimeve në ciklin e parë Bachelor.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1972 Prot.

Korçë, më 19.11.2019

VENDIM

NR. 618, DATË 19.11.2019

PËR

MOSMIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË 29.3.2017 "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 19.11.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, të studentëve të vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe të studentëve të vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1969 Prot.

Korçë, më 19.11.2019

VENDIM

NR. 615, DATË 19.11.2019

PËR
PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË
VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES
STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË
NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve për përfitim të bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 19.11.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitim të bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2082 Prot.

Korçë, më 06.12.2019

VENDIM

NR. 658, DATË 06.12.2019

PËR

PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË
STUDENTËVE, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË
29.3.2017 "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË
PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË
PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË
STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE,
QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË
NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 06.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, të studentëve të vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe të studentëve të vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2083 Prot.

Korçë, më 06.12.2019

VENDIM

NR. 659, DATË 06.12.2019

PËR

MOSMIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË STUDENTËVE, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË 29.3.2017 "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 06.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, të studentëve të vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe të studentëve të vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2085 Prot.

Korçë, më 06.12.2019

VENDIM

NR. 660 DATË 06.12.2019

PËR

PËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bördi i Administrimit, i mbledhur në datën 06.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2086 Prot.

Korçë, më 06.12.2019

VENDIM

NR. 661, DATË 06.12.2019

PËR

MOSPËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE
TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES
STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITYRE NË
NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat priorityre në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 06.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 992 prot

Korçë, më 28/05/2019

VENDIM

Nr. 289, datë 28.05.2019

PËR

DHËNIE SHPËRBLIMI FINANCIAR STUDENTIT ANDREA DULE

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, paragrafi 3, pika c, si dhe në propozimin e Rektorit me nr. 619/1, datë 27.05.2019, "Propozim për dhënie shpërblim financiar studentit Andrea Dule", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 27.05.2019,

VENDOSI

1. T'i akordojë shpërblim financiar z. Andrea Dule, student në Fakultetin e Ekonomisë, Cikli i Parë i Bachelor, programi i studimit financë-kontabilitet, viti i dytë, djalit të mësueses Luiza Dule, e cila humbi jetën në krye të detyrës në muajin dhjetor 2018.
2. Ky shpërblim financiar të jepet për periudhen e vitit akademik 2018-2019, për muajt Maj dhe Qershor dhe për vitin akademik 2019-2020, me kushtin që studentit Andrea Dule të shlyej detyrimet e tij brenda afatit të rregullt të vitit akademik, gjatë studimeve në ciklin e parë Bachelor, në masën 10.000 lekë në muaj.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1047 Prot.

Korçë, më 07.06.2019

VENDIM
NR. 305, datë 07.06.2019

PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PUNËSIMIN
E PERSONELIT ADMINISTRATIV «SHOFER» NË SEKTORIN E
SHËRBIMEVE PRANË DREJTORISË EKONOMIKE

Bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr.138 datë 12.03.2019, "Per miratimin e strukturës dhe organigramës të universitetit për vitin 2019" si dhe Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 182 datë 03.04.2019, "Per miratimin e numrit të punonjësve të universitetit sipas niveleve", për plotësimin e vendit vakant «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 07/06/2019, pasi diskutoi në lidhje me përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të punësimit, bazuar në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenet 49, pika 1, germa f, si dhe në Statutin e Universitetit, nenet 28, pika 1 dhe 45, pika 1,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për punësimin e personelit administrativ «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike.
2. Kandidati për personel administrativ, «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

Kriteret e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës, për të cilin konkurren.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerje të veprës/ave penale.
- Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

Kriteret e veçanta:

- Të ketë kryer shkollën e mesme, vërtetuar me diplomën përkatëse (bashkëngjitur kopje e letërnjoftimit).
 - Të ketë Leje Drejtimi kategoria D
 - Të ketë eksperiencë pune minimum tre vjet, të vërtetuar me librezë pune ose vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore apo Drejtoria Rajonale Tatimore.
3. Vlerësimi i kandidaturave për personel administrativ, «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike, të bëhet nga një komision, i cili të ketë në përbërje të tij të paktën tre anëtarë, i ngritur nga administratori i institucionit.
 4. Komisioni i vlerësimit të kandidaturave, i ngritur sipas pikës 3, të këtij vendimi, do të përcaktojë mënyrën e vlerësimit të kriterëve dhe pikët përkatëse, mbi të cilat do të bazohet në vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit fitues për personel administrativ, «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike.
 5. Aplikimet e kandidatëve për personel administrativ, «Shofer» në Sektorin e Shërbimeve pranë Drejtorisë Ekonomike, të pranohen brenda 10 ditëve nga data e publikimit të njoftimit për shpalljen e konkursit në Buletinin e Njoftimeve Publike.
 6. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof.as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1048 prot

Korçë, më 07 / 06 / 2019

VENDIM

Nr. 306, datë 07.06.2019

PËR
PAGAT E PËRGJEGJËSAVE TË SEKTORËVE NË REKTORAT

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 3, pika 4, gërma ç, ku parashikohet se: "1. Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. 4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës:... ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit;...", në nenin 38, pika 1, gërma ç, ku parashikohet se: "1. Funksionet e Senatit Akademik janë: ... ç) harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të institucionit në të gjitha nivelet;...", në nenin 67, pika 1 ku parashikohet se: "1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi", në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", pika 1/3/b, lidhja 1 dhe lidhja 7, si dhe në shkresën nr. 3778/1 prot., datë 16.04.2019, e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 07.01.2019,

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin dhe kategorizimin e pagave për pozicionin e punës nga "përgjegjës sektori në rektorat" (kategoria IV-a) në "përgjegjës sektori" (kategorinë III-b), në kuadër të strukturës dhe të organigramës së institucionit, miratuar me Vendimin nr. 138, datë 12.03.2019, të Senatit

Akademik të Universitetit, "Për miratimin e strukturës dhe organigramës të Universitetit për vitin 2019" dhe Vendimin nr. 182, datë 03.04.2019, të Bordit të Administrimit të Universitetit, "Për miratimin e numrit të punonjësve të Universitetit sipas niveleve".

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare që nga data 07.06.2019.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1130 prot

Korçë, më 24 / 06 / 2019

VENDIM

Nr. 330, datë 24.06.2019

“PËR

**MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK,
NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV TË UNVERSITETIT”**

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 24 / 06 / 2019, pasi diskutoi në lidhje me nivelet e pagave të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ referuar legjislacionit në fuqi, bazuar në **Ligjin nr. 80/2015**. “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në **nenin 3, pika 4, germa ç**, ku parashikohet se “Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës: ...ç) për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit”,

në **nenin 38, pika 1, germa ç**, ku parashikohet se : “1. Funksionet e Senatit Akademik janë: ... ç) harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të Institucionit në të gjitha nivelet:....”, në **nenin 67, pika 1**, ku parashikohet se: 1. Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të Institucionit të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi”,

në **VKM nr. 329 datë 12.04.2017**, “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” **pika 17**, “Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/ titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”,

në **VKM nr. 748 datë 11.06.2009**, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar,

në VKM nr. 187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", i ndryshuar, pikat 1/3 b; 2, lidhja nr 1; 10, lidhja nr. 7,

në VKM nr. 717 datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar,

në Statutin e Universitetit, neni 34, pika 15, "Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/ titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë",

në Vendimin e Senatit Akademik nr. 138 datë 12.03.2019, "Per miratimin e strukturës dhe organigramës të universitetit për vitin 2019",

si dhe në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 182 datë 03.04.2019, "Për miratimin e numrit të punonjësve sipas niveleve",

VENDOSI:

1. Miratimin e niveleve të pagave të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ sipas legjislacionit në fuqi:

1. Për personelin akademik

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik, në institucionet publike të arsimit të lartë, që jepen mbi bazën e VKM nr. 748 datë 11.06.2009, i ndryshuar, lidhja nr. 1, janë si më poshtë:

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Rektor (titullar institucioni)	139,800
2	Zëvendësrektor, nga kategoria "Profesor"	132,200
3	Zëvendësrektor, nga kategoria "Docent"/"Doktor"	130,500
4	Dekan nga kategoria "Profesor"	132,200
5	Dekan nga kategoria "Docent"/"Doktor"	130,500
6	Zëvendësdekan, nga kategoria "Profesor"	121,000

7	Zëvendësdekan, nga kategoria "Docent"/"Doktor"	106,700
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Profesor"	123,800
9	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Docent"/"Doktor"	106,700
10	Titullar i grupit mësimor-kërkimor kategoria "Profesor"	123,800
11	Titullar i grupit mësimor-kërkimor kateg "Docent"/"Doktor"	106,700
12	Profesor	121,000
13	Profesor i asociuar	105,200
14	Docent (Doktor)	95,800
15	Docent (Master)	91,800
16	Lektor i parë/Kërkues i parë	90,300
17	Lektor/Kërkues	73,400

2. Për personelin ndihmësakademik dhe administrativ

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit ndihmësakademik dhe administrativ, që jepen mbi bazën e VKM nr. 187 datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendëministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", pikat 1/3 b; 2, lidhja nr 1; 10, lidhja nr. 7, janë si më poshtë:

Pozicioni	Kategoria	Paga e grupit
Administrator i universitetit	II-b	1
Drejtor drejtorie	III-a/1	1
Përgjegjës sektori	III-b	1
Kryesekretar në universitet	IV-a	1
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
Bibliotekar në bibliotekën e universitetit	IV-b	1 ose 2 ose 3
Bibliotekar në bibliotekën e fakultetit	IV-b	1 ose 2 ose 3
Administrator i vlerave materiale	IV-b	1 ose 2 ose 3
Laborant me arsim të lartë në universitet	IV-b	1 ose 2 ose 3
Sekretar mësimor	IV-b	1 ose 2 ose 3

3. Për personelin administrativ (punëtor)

Struktura dhe nivelet e pagave për personelin administrativ (punëtor) që jepen mbi bazën e VKM nr. 717 datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetoret”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

Emërtimi i punonjësit	Niveli i pagës, klasa
Magaznier	VI
Shofer	IV
Punonjës shërbimi (kaldajist)	IV
Punonjës shërbimi (mirëmbajtës)	IV
Punonjës pastrimi (sanitar)	I

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2090 Prot.

Korçë, më 06.12.2019

VENDIM

Nr. 662, datë 06.12.2019

PËR
CAKTIMIN E ZNJ. FLORINDA ZEGULLAJ PËR KRYERJEN E DETYRAVE
TË SEKRETARES SË BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49 "Funksionet e Bordit", neni 67 "Personeli administrativ", pika 2 si dhe statutin e Universitetit "Fan Noli",

VENDOSI:

1. Caktimin e Znj. Florinda Zegullaj, me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Prokurimeve Publike dhe Investimeve pranë Drejtorisë Ekonomike, për kryerjen e detyrave të Sekretares së Bordit të Administrimit, duke lënë të pandryshuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar në strukturën e institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2145 Prot.

Korçë, më 17.12.2019

VENDIM

NR. 676, DATË 17.12.2019

PËR

ULJE TË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT PËR STUDENTËT E VITIT TË I-RË DHE II-TË, TË PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL DHE MASTER SHKENCOR, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 780, DATË 26.12.2018 "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJE TË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË",

Bazuar në VKM-në nr. 780, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë", Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I-rë dhe II-të të programeve të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë uljen e tarifës vjetore të studimit në masën 50%, për vitin akademik 2019-2020, për studentët e vitit të I-rë dhe të II-të, të programeve të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, forma e studimeve me kohë të plotë, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2146 Prot.

Korçë, më 17.12.2019

VENDIM

NR. 677, DATË 17.12.2019

PËR

MOSMIRATIMIN E ULJES SË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT PËR
STUDENTËT E VITIT TË I-RË DHE II-TË, TË PROGRAMEVE TË CIKLIT
TË DYTË TË STUDIMEVE, MASTER PROFESIONAL DHE MASTER
SHKENCOR, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 780, DATË 26.12.2018
“PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË
KRITERET PËR ULJE TË TARIFËS VJETORE TË STUDIMIT NË
PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”,

Bazuar në VKM-në nr. 780, datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.12.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I-rë dhe II-të, të programeve të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë uljen e tarifës vjetore të studimit në masën 50%, për vitin akademik 2019-2020, për studentët e vitit të I-rë dhe të II-të, të programeve të ciklit të dytë të studimeve, Master Profesional dhe Master Shkencor, forma e studimeve me kohë të plotë, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2147 Prot.

Korçë, më 17.12.2019

VENDIM

NR. 678 DATË 17.12.2019

PËR

PËR FITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËR FITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 17.12.2019, pasi rishqyrto dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi, të cilat kanë risjell dokumentat e plotësuar konform VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 248 Prot.

Korçë, më 17.12.2019

VENDIM

Nr. 679, datë 17.12.2019

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BORDIT
TË ADMINISTRIMIT

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49 "Funksionet e Bordit", si dhe referuar Vendimit të Bordit nr. 662, datë 06/12/2019 "Për caktimin e znj. Florinda Zegullaj për kryerjen e detyrave të sekretares së Bordit të Administrimit"

VENDOSI:

1. Në nenin 10 të Rregullores së Bordit të Administrimit bëhen këto shtesa:
Në fund të pikës 1 «Në çdo mbledhje të Bordit të Administrimit mbahet procesverbali përkatës» shtohen fjalët «nga Sekretari i Bordit».
2. Në rregulloren e Bordit të Administrimit të shtohet neni me nr. **6/1** «Sekretari i Bordit të Administrimit» dhe të listohen detyrat e tij si më poshtë vijon:
 - Sekretari i Bordit të Administrimit zgjidhet me shumicën e votave nga anëtarët e Bordit pasi propozohet nga anëtarët e Bordit.
 - Sekretari asiston veprimtarinë e Bordit të Administrimit, duke përpiluar në formë elektronike procesverbalet e mbledhjeve dhe duke i protokolluar ato.
 - Sekretari harton listprezencën e mbledhjeve në fund të çdo muaji.
 - Sekretari i propozon rendin e ditës Kryetarit duke marrë parasysh kërkesat e ligjit dhe kërkesat që mund të kenë ardhur nga njësi të universitetit.
 - Sekretari ndjek dhe shpërndan njoftimet për anëtarët e bordit.
 - Grumbullon dhe ve në dispozicion të të gjithë anëtarëve të bordit dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për mbledhjet e bordit.
 - Në rast mungese të tij për arsye objektive për një mbledhje të njoftuar, sekretari zëvendësohet nga një anëtar i caktuar prej Kryetarit ose një punonjës i administratës së Rektoratit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2149 Prot.

Korçë, më 17.12.2019

VENDIM

Nr. 680 datë 17.12.2019

PËR
NJË SHITESË NË RREGULLOREN FINANCIARE

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49 "Funksionet e Bordit", neni 67 "Personeli administrativ", pika 2

VENDOSI:

1. Në rregulloren financiare të shtohet neni me nr.7/1 me përmbajtje «Masa e shpërblimit mujor për Sekretarin e Bordit për punën në mbështetje të veprimtarisë së Bordit të Administrimit të jetë 10,000 lekë». Ky shpërblim t'i shtohet pagës mujore që ai përfiton në Universitetin «Fan S.Noli».
2. Ngarkohet Administratori për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT
Prof.as.dr.Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
SENATI AKADEMIK, BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2184 prot

Korçë, më 24/12/2019

VENDIM

Nr. 685, datë 24.12.2019

PËR
MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË TË
INSTITUCIONIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërma g, si dhe neni 49 "Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë", pika 1, gërma h, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit pasi diskutuan mbi raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2018-2019, të hartuar nga Rektorati i Universitetit si dhe duke u bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nr. 5, datë 19.2.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", pika 4, në mbledhjen e përbashkët të datës 24.12.2019

VENDOSËN:

1. Të miratojnë raportin vjetor të veprimtarisë të institucionit për vitin akademik 2018-2019, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT
Prof.as.dr.Mamica Nene

KRYETARI I SENATIT
REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
REKTORATI

Nr. 2007 prot

Korçë, më 25 / 11 / 2019


Lënda: *Kërkesë për përcaktimin e numrit maksimal të orëve suplementare jashtë auditorit, të cilat paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar*

Drejtuar:

SENATIT AKADEMIK
BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, kërkojmë nga ana juaj përcaktimin e numrit maksimal të orëve suplementare jashtë auditorit, të cilat paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, i cili të jetë deri në 100 orë.

REKTORI
Prof. dr. Ali Jashari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2012 Prot.

Korçë, më 25.11.2019

VENDIM

Nr. 627, datë 25.11.2019

PËR

**PËRCAKTIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË ORËVE SUPLEMENTARE
JASHTË AUDITORIT, QË PAGUHEN, REFERUAR PËRCAKTIMEVE TË
UDHËZIMIT NR. 29, DATË 10.09.2018, "PËR VEPRIMTARINË DHE
NGARKESËN MËSIMORE TË PERSONELIT AKADEMIK NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR**

Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 25/11/2019, pasi u njoh dhe diskutoi në lidhje me kërkesën e Rektoratit nr. 2007 prot., datë 25/11/2019 si dhe Vendimin nr. 626, datë 25/11/2019, të Senatit Akademik, për përcaktimin e numrit maksimal të orëve suplementare jashtë auditorit, të cilat mund të paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, «Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë», Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, si dhe në kërkesën e Rektoratit nr. 2007 prot., datë 25/11/2019 dhe në Vendimin nr. 626, datë 25/11/2019, të Senatit Akademik

VENDOSI:

1. Numri maksimal i orëve suplementare jashtë auditorit, të cilat paguhen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, kreu II, pika 1 dhe kreu III, pika 2, të jetë deri në 100 orë.
2. Ngarkohet administratori i institucionit me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof.as.dr Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2014 Prot.

Korce me: 25. 11. 2019

VENDIM

Nr. 628, datë 25. 11. 2019

**PËR NDRYSHIM TE DESTINACIONIT TE FONDEVE BUXHETORE TE GRANTIT TE VITIT 2019,
"PER MBULIMIN E ZERIT PAGA DHE SIGURIME PER VITIN 2019"**

Bordi i Administrimit i Universitetit "Fan S. Noli", i mbledhur në datën 25 / 11 / 2019, pasi shqyrtoi kërkesën e Administratorit dhe Rektorit të Universitetit për:

Ndryshim te destinacionit te perdorimit te fondeve buxhetore te grantit per vitin 2019, i ndryshuar, "Per mbulimin e zerit Paga dhe Sigurime per vitin 2019" në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", neni 49, pika "a", "ë";

VENDOSI

1. Ndryshim te destinacionit te perdorimit te fondeve buxhetore te grantit per vitin 2019, i ndryshuar, "Per mbulimin e zerit Paga dhe Sigurime per vitin 2019" (*bashkëngjitur materiali perkates*).
2. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

Bordi i Administrimit

KRYETARI

Memico Neup





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1973 Prot.

Korçë, më 19.11.2019

VENDIM

NR. 619, DATË 19.11.2019

PËR
KTHIMIN E MASËS SË TARIFËS SË REGJISTRIMIT DHE TARIFËS SË
SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019, STUDENTIT FLOBERT
PINDERI

Bazuar në VKM-në nr. 216, datë 20.04.2018, "Për pranimin e kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2018-2019", pika 2, si dhe në kërkesën e Fakultetit të Bujqësisë nr. 1966 prot., datë 19.11.2019, Bordi i Administrimit i mbledhur në datën 19.11.2019,

VENDOSI:

1. T'i kthehet shuma e tarifës së shkollimit prej 10.000 lekësh, studentit Flobert Pinderi, kursi I, Fakulteti i Bujqësisë.
2. T'i kthehet shuma e tarifës së regjistrimit prej 1.600 lekësh, studentit Flobert Pinderi, kursi I, Fakulteti i Bujqësisë.

Bashkëlidhur vendimit është dokumentacioni provues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1940 Prot.

Korçë, më 19. 11 .2019

VENDIM

NR. 616, DATË 19. 11 .2019

PËR

MOSPËRFITIMIN E BURSËS NGA STUDENTËT, SIPAS PËRCAKTIMEVE
TË VKM-SË NR. 903, DATË 21.12.2016, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
PËR PËRFITIMIN E BURSAVE NGA FONDI I MBËSHTETJES
STUDENTORE, PËR STUDENTËT E SHKËLQYER, STUDENTËT QË
STUDIOJNË NË PROGRAMET STUDIMI NË FUSHAT PRIORITARE NË
NEVOJË", TË NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 903, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programet studimi në fushat prioritare në nevojë", të ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 19. 11 .2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të mos miratojë përfitimin e bursës për vitin akademik 2019-2020, nga studentët e vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe nga studentët e vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nenë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1971 Prot.

Korçë, më 19.11.2019

VENDIM

NR. 617, DATË 19.11.2019

PËR

PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË
STUDENTËVE, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË VKM-SË NR. 269, DATË
29.3.2017 "PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË
PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË
PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË
STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE,
QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT", TË
NDRYSHUAR

Bazuar në VKM-në nr. 269, datë 29.03.2017, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve, ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, Bordi i Administrimit, i mbledhur në datën 19.11.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin vërtetues për statusin ligjor, të paraqitur nga studentë të vitit I, II dhe III të ciklit të parë të studimeve (Bachelor) dhe studentë të vitit I dhe II të programeve të studimeve profesionale, forma e studimeve me kohë të plotë,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2019-2020, të studentëve të vitit I, II dhe III, të ciklit të parë të studimeve, "Bachelor", dhe të studentëve të vitit I dhe II, të programeve të studimeve profesionale, sipas listës emërore bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet administratori i institucionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. as. dr. Mamica Nene

